



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government of Kosovo
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Lista preliminare e personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë

Raport, 2026

Ky raport paraqet metodologjinë, procesin e dokumentimit dhe analizën e të dhënave të Listës preliminare të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë. Lista përmban rastet e verifikuara nga IKKL për periudhën e luftës (1 janar 1998 – 20 qershor 1999) dhe periudhën e pasluftës (21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000) dhe përbën fazën e parë të lansimit të databazës institucionale të IKKL-së.

© Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Prishtinë, korrik 2026

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	08
Përmbledhje Ekzekutive	10
Parime për interpretimin e të dhënave dhe përdorimin e raportit	12
Parime për përdorimin e terminologjisë	13
KAPITULLI I	14
MANDATI I IKKL-SË DHE FUSHËVEPRIMI I LISTËS	14
1.1. Mandati institucional	14
1.2. Fushëveprimi i kësaj faze të dokumentimit	14
1.3. Qëllimi i listës.....	14
1.4. Fushëveprimi dhe kriteret e përfshirjes në listë.....	15
1.5. Kategoritë e rasteve të dokumentuara	16
1.6. Rëndësia e dokumentimit	16
KAPITULLI II	17
BURIMET E TË DHËNAVE DHE PROCESI I HARMONIZIMIT	17
2.1. Hyrje	17
2.2. Burimet e të Dhënave	17
2.2.1. Burime Institucionale.....	17
2.2.2. Burime të Organizatave Vendore dhe Ndërkombëtare	18
2.2.3. Burime Plotësuese	18
2.3. Parimet e Integritit të Burimeve	19
2.4. Procesi i Harmonizimit.....	19
KAPITULLI III	21
METODOLOGJIA E VERIFIKIMIT	21
3.1 Qasja Metodologjike.....	21

3.2 Vlerësimi i besueshmërisë së burimeve.....	21
3.3 Përdorimi i të dhënave të harmonizuara në procesin e verifikimit.....	21
3.4 Verifikimi, riverifikimi dhe validimi.....	22
3.5 Identifikimi dhe trajtimi i regjistrimeve të dyfishta.....	22
3.6 Kontrolli i cilësisë dhe gjurmueshmëria.....	22
3.7 Kufizimet metodologjike dhe zhvillimet e ardhshme.....	23
KAPITULLI IV	24
PASQYRA E PËRGJITHSHME E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË.....	24
4.1 Hyrje.....	24
4.2 Numri i përgjithshëm i personave të përfshirë në listë.....	24
4.3 Shpërndarja sipas kategorive.....	25
4.4 Personat e përfshirë në listë sipas kategorisë etnike.....	26
KAPITULLI V	28
ANALIZA DEMOGRAFIKE E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË.....	28
5.1 Hyrje.....	28
5.2 Personat e përfshirë në listë sipas gjinisë.....	28
5.3 Personat e përfshirë në listë sipas grupmoshave.....	29
KAPITULLI VI	31
ANALIZA GJEOGRAFIKE E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË.....	31
6.1 Hyrje.....	31
6.2 Personat e përfshirë në listë sipas rajoneve.....	31
6.3 Personat e përfshirë në listë sipas komunave.....	32
6.4 Komunitetet më të Prekura të Kosovës.....	32
KAPITULLI VII	33
ANALIZA KOHORE E RASTEVE TË DOKUMENTUARA.....	33
7.1 Hyrje.....	33
7.2 Personat e përfshirë në listë gjatë luftës dhe pas luftës.....	33
7.3 Personat e përfshirë në listë sipas viteve.....	33
7.4 Personat e përfshirë në listë sipas muajve.....	34
7.5 Periudhat me numrin më të lartë të personave të përfshirë në listë	35
KAPITULLI VIII	36
CILËSIA E TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMI I LISTËS PRELIMINARE.....	36
8.1 Hyrje.....	36

8.2 Struktura e të dhënave.....	36
8.3 Parimet e Administrimit të Databazës	36
8.4 Harmonizimi i Burimeve.....	37
8.5 Kufizimet dhe Përditësimi i listës preliminare	37
KAPITULLI IX.....	38
PËRMBLEDHJA E GJETJEVE KRYESORE.....	38
9.1 Gjetjet Statistikore.....	38
9.2 Gjetjet Demografike.....	38
9.3 Gjetjet Gjeografike.....	38
9.4 Gjetjet Kohore.....	38
9.5 Gjetja Kryesore e Raportit.....	38
KAPITULLI X	39
RËNDËSIA E LISTËS PËR KUJTESËN KOLEKTIVE DHE DREJTËSINË TRANZICIONALE.....	39
10.1 Kujtesa Kolektive.....	39
10.2 Hulumtimi dhe Edukimi.....	39
10.3 Rëndësia për Politikat Publike dhe Institucionet e Republikës së Kosovës.....	39
10.4 Drejtësia Tranzicionale.....	40
KONKLUZIONE	41

Dokumentimi i viktimave të luftës në Kosovë është nga detyrat më të rëndësishme institucionale në procesin e ndërtimit të kujtesës kolektive, avancimit të së vërtetës dhe forcimit të bazës faktike për hulumtim, edukim dhe politika publike. Për më shumë se dy dekada pas përfundimit të luftës, të dhënat mbi personat e vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës janë mbledhur, ruajtur dhe publikuar nga institucione, organizata dhe individë të ndryshëm, duke krijuar fonde të rëndësishme të të dhënave që kanë kontribuar në ruajtjen e kujtesës dhe dokumentimin e pasojave njerëzore të luftës. Megjithatë, ekzistenca e burimeve të shumta, metodologjive të ndryshme të dokumentimit dhe standardeve jo të njëjta të verifikimit ka bërë që në hapësirën publike të qarkullojnë të dhëna të ndryshme mbi numrin dhe karakteristikat e viktimave të luftës. Për këtë arsye, Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), në kuadër të mandatit ligjor, ka inicuar procesin e harmonizimit, verifikimit dhe standardizimit të të dhënave për personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës në Kosovë.

Ky proces mbështetet në rivlerësimin, integrimin dhe harmonizimin e burimeve ekzistuese sipas kriteve të unifikuara dhe procedurave të standardizuara të verifikimit. Përmes këtij procesi është synuar krijimi i një Liste të vetme institucionale, të besueshme dhe të gjurmueshme, të mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm, hulumtime shtesë në terren dhe standardet profesionale të dokumentimit. Mandati dokumentues i IKKL-së përfshin kategori të ndryshme të viktimave, të mbijetuarve dhe personave të tjerë të prekur nga lufta. Krahas personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës, puna e Institutit përfshin edhe dokumentimin e torturës, burgosjes, dëbimit me forcë, të shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhunës seksuale gjatë luftës dhe formave të tjera të dëmit dhe shkeljeve të lidhura me luftën.

Megjithatë, ky raport nuk trajton tërësinë e këtyre kategorive, por paraqet fazën e parë të procesit dhe fokusohet vetëm në personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës. Lista ka karakter preliminar dhe mbetet e hapur për përditësime të bazuara në dokumente, informacione dhe rezultate të reja të hulumtimit. Në kohën e hartimit të raportit, 178 raste mbeten në proces verifikimi dhe, për këtë arsye, nuk janë përfshirë në Listë. Për rrjedhojë, përditësimet e ardhshme mund të sjellin shtimin e rasteve të reja, korrigjimin e të dhënave ekzistuese, rikategorizimin e rasteve ose rishikimin e përfshirjes së tyre, në përputhje me metodologjinë e IKKL-së. Ky raport paraqet metodologjinë dhe analizën e të dhënave të Listës për periudhën e luftës (1 janar 1998 – 20 qershor 1999) dhe periudhën e pasluftës (21 qershor 1999 – 31 dhjetor 2000). Raporti përmban gjithashtu analiza sipas kategorisë së rastit, përkatësisë etnike, gjinisë, grupmoshës, shpërndarjes gjeografike dhe periudhës kohore.

Publikimi i Listës synon të krijojë një referencë institucionale të verifikueshme dhe të gjurmueshme, në shërbim të së vërtetës, kujtesës, hulumtimit shkencor dhe interesit publik. Rëndësia e këtij procesi shtrihet përtej dimensionit administrativ dhe statistikor. Për familjet e personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës, dokumentimi institucional paraqet një formë të njohjes publike dhe ruajtjes së kujtimit për më të dashurit e tyre.

Për shoqërinë, ky proces kontribuon në ndërtimin e një kujtese kolektive të bazuar në fakte dhe në promovimin kulturës së përgjegjshme të kujtesës. Për studiuesit dhe institucionet akademike, Lista përbën bazën fillestare për zhvillimin e databazës institucionale dhe ofron mundësi për analiza historike, sociopolitike, juridike dhe demografike mbi pasojat e luftës në Kosovë. Për institucionet e Republikës së Kosovës, raporti do të shërbejë si referencë institucionale për zhvillimin e politikave publike, hartimin e dokumenteve strategjike, përfaqësimin institucional dhe komunikimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë lidhur me pasojat njerëzore të luftës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet metodologjinë, procesin e dokumentimit dhe rezultatet e Listës preliminare të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë. Lista mbulon periudhën e luftës, nga 1 janari 1998 deri më 20 qershor 1999, si dhe periudhën e pasluftës nga 21 qershori 1999 deri më 31 dhjetor 2000, për rastet me lidhje të drejtpërdrejtë dhe të dokumentuara me luftën dhe pasojat e saj.

Raporti shpjegon qasjen e ndjekur, burimet e përdorura dhe kriteret mbi bazën e të cilave të dhënat janë identifikuar, krahasuar dhe verifikuar. Ai paraqet gjithashtu rezultatet e Listës preliminare, të ndërtuar përmes harmonizimit të evidencave ekzistuese, të plotësuara me hulumtime shtesë, verifikime në terren dhe grumbullim të dokumentacionit nga IKKL-ja. Lista nuk është rezultat i bashkimit mekanik të burimeve ekzistuese, por i një procesi të standardizuar të identifikimit, harmonizimit, verifikimit dhe validimit të secilit rast individual, të zhvilluar sipas metodologjisë së IKKL-së.

Procesi është mbështetur në analizën dhe krahasimin sistematik të burimeve institucionale, duke përfshirë evidencat e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, dokumentacionin e komunave dhe institucioneve publike, si dhe materialet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare që kanë dokumentuar pasojat njerëzore të luftës. Këto përfshijnë Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Fondin për të Drejtën Humanitare (Humanitarian Law Center – HLC), Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe burime të tjera relevante. Krahas harmonizimit të këtyre burimeve, IKKL-ja ka zhvilluar hulumtime dhe verifikime shtesë në terren, me qëllim të plotësimit të të dhënave, saktësisimit të identitetit të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës, si dhe evidentimit të rasteve që mungonin ose paraqiteshin në mënyrë të paplotë në burimet ekzistuese.

Lista përfshin gjithsej 13,227 raste të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës, për periudhën nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Ajo përbën evidencën më të plotë institucionale deri më sot për këto tri kategori, të ndërtuar përmes harmonizimit të burimeve ekzistuese dhe verifikimeve shtesë të realizuara nga IKKL-ja. Rezultatet e paraqitura në këtë raport ofrojnë analiza të përgjithshme të rasteve të dokumentuara sipas kategorisë së rasti i/e vrarë, i/e zhdukur me dhunë dhe i/e vdekur si pasojë e luftës, si dhe sipas gjinisë, grupmoshës, përkatësisë etnike, shpërndarjes gjeografike dhe periudhës kohore.

Lista është hartuar në përputhje me mandatin ligjor dhe metodologjinë e IKKL-së. Gjatë procesit të harmonizimit dhe verifikimit është konstatuar se një numër rastesh që figurojnë në evidencat e institucioneve ose organizatave të tjera nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara për përfshirje në Listë. Kryesisht bëhet fjalë për persona të vrarë jashtë territorit të Kosovës ose për raste të cilat, bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe të dokumentuar me luftën në Kosovë ose pasojat e saj.

Lista quhet “preliminare” sepse mbetet e hapur për përditësime të bazuara në dokumente, dëshmi dhe informacione të reja. Ky emërtim nuk nënkupton se rastet e përfshira janë të paverifikuara. Publikimi i Listës përbën fazën e parë të zhvillimit të databazës institucionale, e cila do të plotësohet, përditësohet dhe zgjerohet në fazat e mëvonshme të procesit të dokumentimit. Meqenëse termi “viktimë” ka kuptim më të gjerë se kategoritë e trajtuara në këtë publikim, vlen të theksohet se ky raport nuk paraqet dokumentimin e të gjitha viktimave ose personave të prekur nga lufta, por vetëm të tri kategorive të përcaktuara në titullin dhe fushëveprimin e tij.

PARIME PËR INTERPRETIMIN E TË DHËNAVE DHE PËRDORIMIN E RAPORTIT

Të dhënat e paraqitura në Listë dhe në këtë raport duhet të interpretohen brenda fushëveprimit material, kohor, territorial dhe metodologjik të publikimit. Raporti trajton vetëm personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës, të cilët i kanë plotësuar kriteret e IKKL-së në kohën e hartimit të Listës.

Për të siguruar interpretimin e drejtë të të dhënave, duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme:

1. Të dhënat e përfshira në raport bazohen në burimet dhe dokumentacionin që kanë qenë të qasshme gjatë procesit të hulumtimit, dokumentimit dhe verifikimit. Përfshirja ose mungesa e një personi në Listë pasqyron dokumentacionin dhe informacionet e verifikuara që kanë qenë në dispozicion të IKKL-së në kohën e publikimit.
2. Dokumentimi është proces i vazhdueshëm. Dëshmitë dhe informacionet e reja mund të sjellin plotësimin, korrigjimin, rikategorizimin ose përditësimin e Listës. Një nga qëllimet e publikimit të saj është edhe mundësia e komunikimit me publikun, studiuesit dhe familjet e personave të përfshirë në Listë. Përmes këtij komunikimi pritet të sigurohen informacione shtesë, të cilat mund të kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e mëtejshëm të të dhënave.
3. Raporti ka karakter hulumtues dhe dokumentues. Ai nuk zëvendëson procedurat gjyqësore, hetimore ose administrative dhe nuk përcakton përgjegjësi penale individuale ose kolektive.
4. Kategoritë dhe klasifikimet statistikore janë zbatuar sipas metodologjisë së IKKL-së, me qëllim të standardizimit dhe krahasueshmërisë së të dhënave. Edhe pse gjatë procesit të hulumtimit janë identifikuar informacione lidhur me statusin e një pjese të personave të përfshirë në Listë, këto të dhëna nuk janë paraqitur në këtë fazë të publikimit. Kjo qasje është ndjekur për të siguruar zbatimin e kriterëve të njëjta metodologjike për të gjitha rastet. Në fazat e ardhshme, pas përfundimit të procesit të plotë të verifikimit dhe klasifikimit, parashihet publikimi i analizave shtesë, përfshirë ndarjen e personave sipas statusit të tyre, si viktimat civile ose pjesëtarë të forcave të armatosura.

Procesi i dokumentimit nuk përfundon me publikimin e këtij raporti, por do të vazhdojë përmes hulumtimeve të mëtejshme, verifikimit të vazhdueshëm të të dhënave dhe integritetit të dokumentacionit dhe dëshmiave të reja. IKKL-ja fton institucionet publike, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, studiuesit, familjet e personave të përfshirë në Listë, si dhe qytetarët që posedojnë dokumente, dëshmi ose informacione relevante, të bashkëpunojnë me Institutin dhe të kontribuojnë në plotësimin, përmirësimin dhe verifikimin e mëtejshëm të kësaj evidence, në funksion të së vërtetës, kujtesës institucionale dhe interesit publik.

PARIME PËR PËRDORIMIN E TERMINOLOGJISË

Për qëllime të këtij publikimi përdoren termat “Lista preliminare”, “Raporti” dhe “Databaza” me kuptimet e mëposhtme:

1. Lista preliminare ose Lista është produkti që publikohet në këtë fazë të procesit dhe përmban rastet e verifikuara të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës.
2. Raporti është dokumenti shoqërues që paraqet metodologjinë e përdorur, procesin e dokumentimit dhe analizën e të dhënave të Listës.
3. Databaza është sistemi institucional i IKKL-së, në zhvillim e sipër, në të cilin ruhen dhe ndërlidhen të dhënat, dokumentacioni burimor, historiku i verifikimit dhe informacionet e tjera për secilin rast. Ajo do të plotësohet, përditësohet dhe zgjerohet në përputhje me rezultatet e hulumtimeve dhe procesit të verifikimit.

Gjithashtu, në këtë raport përdoret kryesisht terminologji përshkruese, si “persona të vrarë”, “persona të zhdukur me dhunë” dhe “persona të vdekur si pasojë e luftës”. Megjithatë, kjo nuk nënkupton kufizimin e kuptimit juridik ose shoqëror të termit “viktimë”. Dihet që, sipas së drejtës ndërkombëtare, legjislacionit vendor dhe praktikave të dokumentimit, termi “viktimë” përfshin edhe kategori të tjera të personave të prekur nga lufta, përfshirë të mbijetuarit e torturës, burgosjes, dëbimit me forcë, dhunës seksuale dhe formave të tjera të dëmit ose të shkeljeve të lidhura me luftën. Megjithatë, ky raport dhe Lista që e shoqëron kanë për objekt vetëm dokumentimin e personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës. Për rrjedhojë, kur në raport përdoret termi “viktimë”, ai duhet të kuptohet vetëm në kuadër të këtyre tri kategorive dhe nuk përfaqëson tërësinë e kategorive që përfshihen në mandatin dokumentues të IKKL-së.

KAPITULLI I

MANDATI I IKKL-SË DHE FUSHËVEPRIMI I LISTËS

1.1 MANDATI INSTITUCIONAL

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) është institucion publik i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 08/L-177, me mandat për dokumentimin, hulumtimin, mbledhjen, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave që lidhen me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe pasojat e tyre. Mandati i Institutit përfshin dokumentimin e kategorive të ndryshme të viktimave, të mbijetuarve dhe personave të tjerë të prekur nga lufta, si dhe dokumentimin e dëmeve dhe pasojave të tyre. Një nga prioritetet kryesore të IKKL-së është zhvillimi i databazës institucionale për dokumentimin e pasojave njerëzore të luftës, përmes integritit, harmonizimit dhe verifikimit të të dhënave nga burime të ndryshme, të plotësuara me hulumtime shtesë. Dokumentimi institucional synon të kontribuojë në ruajtjen e kujtesës, zhvillimin e politikave publike dhe avancimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale.

1.2 FUSHËVEPRIMI I KËSAJ FAZE TË DOKUMENTIMIT

Kjo fazë e dokumentimit kufizohet në tri kategori: personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës. Përfshirja vetëm e këtyre kategorive në Listë nuk nënkupton se ato përbëjnë tërësinë e viktimave të luftës në Kosovë. Kategoritë e tjera që përfshihen në mandatin hulumtues të IKKL-së do të trajtohen në faza të veçanta të dokumentimit.

1.3 QËLLIMI I LISTËS

Ndërtimi i Listës është iniciuar për t'iu përgjigjur nevojës për krijimin e një evidence institucionale të unifikuar, të standardizuar dhe të verifikuar mbi personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës në Kosovë.

Objektivat kryesore të këtij procesi janë:

- Identifikimi, krahasimi, analizimi dhe integrimi i burimeve ekzistuese;
- Harmonizimi i të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme në përputhje me standardet profesionale të dokumentimit;
- Verifikimi dhe standardizimi i rasteve individuale;
- Eliminimi i duplikateve përmes verifikimit të dokumentacionit dhe përdorimit të teknologjisë digjitale;
- Përmirësimi i cilësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave;
- Krijimi i një Liste të verifikuar të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës, e cila do të shërbejë si referencë institucionale për hulumtim, analiza dhe hartimin e politikave publike.

Lista mbetet e hapur për përditësime, pasi që procesi i dokumentimit vazhdon. Publikimi i saj synon, ndër të tjera, përfshirjen e familjeve të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës, institucioneve, organizatave dhe qytetarëve që posedojnë dokumente, dëshmi ose informacione relevante që deri më tani nuk kanë qenë në dispozicion të IKKL-së. Këto materiale mund t'i dorëzohen Institutit për shqyrtim, ndërsa çdo informacion i ri do t'i nënshtrohet procesit të verifikimit sipas metodologjisë së IKKL-së dhe, nëse konfirmohet, do të përfshihet në përditësimet e ardhshme të Listës. Procesi i dokumentimit është zhvilluar mbi parimet e objektivitetit, paanshmërisë, profesionalizmit dhe respektimit të metodologjisë së IKKL-së, e cila bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

1.4 FUSHËVEPRIMI DHE KRITERET E PËRFSHIRJES NË LISTË

Lista është hartuar mbi bazën e kriterëve metodologjike, kohore dhe territoriale të përcaktuara nga IKKL-ja. Ajo përfshin vetëm personat që, në përputhje me metodologjinë e Institutit, klasifikohen si persona të vrarë, persona të zhdukur me dhunë ose persona të vdekur si pasojë e luftës. Lista mbulon periudhën e luftës, nga 1 janari 1998 deri më 20 qershor 1999, si dhe periudhën nga 21 qershori 1999 deri më 31 dhjetor 2000, vetëm për rastet kur është dokumentuar lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet vrasjes, zhdukjes ose vdekjes dhe ngjarjeve të luftës në Kosovë. Përfshirja e kësaj periudhe pasluftës bazohet në parimin metodologjik se pasojat njerëzore të luftës nuk përfunduan me ndërprerjen e luftimeve. Përfshirja në Listë kushtëzohet nga përmbushja e kriterëve metodologjike të IKKL-së dhe nga ekzistenca e dokumentacionit të mjaftueshëm për verifikimin e secilit rast. Gjatë vlerësimit shqyrtohet lidhja faktike dhe e dokumentuar e rastit me luftën në Kosovë, duke marrë parasysh, sipas rastit, vendbanimin, vendin ku ka ndodhur ngjarja, vendin ku janë marrë plagët, vendin e zhdukjes dhe çdo rrethanë tjetër relevante të dokumentuar.

Në këtë kuadër, në Listë përfshihen personat që plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

1. Kanë lindur, kanë jetuar ose kanë pasur vendbanimin në territorin e Kosovës në kohën e luftës;
2. Kanë pësuar plagë vdekjeprurëse ose janë zhdukur në territorin e Kosovës në rrethana të lidhura drejtpërdrejt me luftën;
3. Kanë humbur jetën si pasojë e drejtpërdrejtë e plagëve të marra gjatë luftës në Kosovë;
4. Bazuar në dokumentacionin e verifikuar, kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjet e luftës në Kosovë.

Gjatë procesit të harmonizimit dhe verifikimit, janë identifikuar edhe raste që figurojnë në evidencat e institucioneve ose organizatave të tjera, por që nuk janë përfshirë në Listë. Kryesisht bëhet fjalë për persona të vrarë jashtë territorit të Kosovës ose për raste që, bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjet e luftës në Kosovë, sipas mandatit ligjor dhe metodologjisë së Institutit. Si rezultat i zbatimit të këtyre kriterëve metodologjike, mbi 267 raste nuk janë përfshirë në Listë. Megjithatë mospërfshirja e tyre nuk nënkupton mohim të statusit të viktimës ose vlerësim mbi rëndësinë e këtyre rasteve, por pasqyron zbatimin e njëtrajtshëm të kriterëve metodologjike dhe respektimin e mandatit ligjor të IKKL-së.

1.5 KATEGORITË E RASTEVE TË DOKUMENTUARA

Për qëllime metodologjike dhe për të siguruar standardizimin e evidencës, personat e përfshirë klasifikohen në tri kategori kryesore:

- 1./e vrarë – personat që kanë humbur jetën si rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të luftës, përfshirë vrasjet, ekzekutimet, masakrat, bombardimet dhe forma të tjera të dhunës që lidhen drejtpërdrejt me luftën;
- 2./e vdekur si pasojë e luftës – personat që kanë pësuar plagë, lëndime ose pasojë të tjera të drejtpërdrejta të luftës, të cilat kanë shkaktuar vdekjen e tyre gjatë ose pas përfundimit të luftës, brenda periudhës së mbuluar nga ky raport;
- 3./e zhdukur me dhunë – personat, fati i të cilëve mbetet i pazbardhur dhe për të cilët ekzistojnë evidenca të besueshme se zhdukja e tyre lidhet me rrethanat e luftës në Kosovë.

Ky kategorizim bazohet në evidencat më të besueshme të disponueshme në kohën e verifikimit dhe mund të rishikohet në rast se sigurohen dëshmi ose informacione të reja.

Në këtë fazë të dokumentimit, nuk është bërë klasifikimi i rasteve sipas statusit të personave (civilë ose pjesëtarë të forcave të armatosura). Kjo ndarje do të publikohet në fazat e ardhshme, pas përfundimit të procesit të verifikimit dhe klasifikimit, në përputhje me metodologjinë e Institutit dhe standardet ndërkombëtare të dokumentimit.

1.6 RËNDËSIA E DOKUMENTIMIT

Përtej dimensionit teknik dhe statistikor, dokumentimi institucional i pasojave njerëzore të luftës ka rëndësi të veçantë shoqërore, akademike dhe institucionale. Në aspektin shoqëror, ai kontribuon në ruajtjen e kujtesës kolektive dhe në njohjen institucionale të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës. Në aspektin akademik, krijon bazë të besueshme për hulumtime historike, juridike, politike, sociologjike dhe demografike mbi pasojat e luftës. Në aspektin institucional, Lista siguron një referencë të standardizuar për institucionet publike dhe përbën bazën fillestare për zhvillimin e databazës institucionale të IKKL-së. Në këtë mënyrë, ajo do të shërbejë si instrument i rëndësishëm për mbështetjen e proceseve të drejtësisë tranzicionale dhe të politikave shtetërore për ndërtimin e një kujtese kolektive të bazuar në fakte dhe evidencë të dokumentuar.

KAPITULLI II

BURIMET E TË DHËNAVE DHE PROCESI I HARMONIZIMIT

2.1 HYRJE

Proceset e dokumentimit të personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë janë zhvilluar për më shumë se dy dekada nga institucione publike, organizata vendore dhe ndërkombëtare, studiues dhe individë të ndryshëm. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, janë krijuar databaza, publikime dhe arkiva që përmbajnë informacione mbi pasojat njerëzore të luftës. Ndonëse këto burime përbëjnë bazë të rëndësishme për dokumentim, ato janë krijuar në periudha të ndryshme, për qëllime të ndryshme dhe sipas metodologjive jo të njëjta të mbledhjes, klasifikimit dhe verifikimit të të dhënave. Për pasojë, ndërmjet tyre janë evidentuar dallime në strukturën e të dhënave, kriteret e përfshirjes, terminologjinë e përdorur dhe nivelin e dokumentimit të rasteve. Në këtë kontekst, njëra nga detyrat kryesore të IKKL-së ka qenë krijimi i një procesi të standardizuar për analizimin, harmonizimin dhe integrimin e burimeve ekzistuese, të plotësuar me hulumtime dhe verifikime shtesë. Qëllimi i këtij procesi është krijimi i një evidence të vetme institucionale, të besueshme dhe të gjurmueshme për personat e vrarë, personat e zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës në Kosovë.

2.2 BURIMET E TË DHËNAVE

Lista e hartuar nga IKKL-ja mbështetet në një gamë të gjerë burimesh, të cilat, për qëllime metodologjike, janë klasifikuar në tri kategori kryesore:

- Burime institucionale;
- Burime të organizatave vendore dhe ndërkombëtare;
- Burime plotësuese.

2.2.1 BURIME INSTITUCIONALE

Burimet institucionale kanë shërbyer për verifikimin e identitetit, plotësimin e të dhënave të munguara, krahasimin e informacioneve dhe vlerësimin e rrethanave të rasteve të dokumentuara. Burimet institucionale të përdorura gjatë këtij procesi përfshijnë:

- Regjistra dhe evidenca shtetërore, përfshirë të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) dhe institucioneve të tjera relevante;
- Evidenca për personat e zhdukur me dhunë, të siguruara nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe mekanizma të tjerë institucionalë, që trajtojnë çështjen e personave të zhdukur;
- Dokumentacion administrativ dhe civil, përfshirë certifikatat e lindjes, certifikatat e vdekjes, ekstraktet e gjendjes civile dhe dokumente të tjera zyrtare të përdorura për verifikimin e identitetit dhe të të dhënave personale;
- Dokumente të institucioneve të drejtësisë, përfshirë aktakuza, aktgjykime, shkresa dhe materiale të tjera gjyqësore që lidhen me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë;
- Materiale të siguruara nga Arkivi i IKKL-së, arkivat komunale dhe institucione të tjera publike që ruajnë dokumentacion relevant për periudhën e trajtuar.

Përdorimi i këtyre burimeve ka mundësuar krahasimin e të dhënave nga institucione të ndryshme, identifikimin e mospërputhjeve dhe plotësimin e informacioneve të munguara. Asnjë burim institucional nuk është trajtuar si i mjaftueshëm ose përfundimtar në vetvete. Çdo informacion është vlerësuar në raport me burimet dhe dokumentacionin tjetër të disponueshëm, në përputhje me metodologjinë e IKKL-së.

2.2.2 BURIME TË ORGANIZATAVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Një pjesë e rëndësishme e procesit të dokumentimit është mbështetur në databazat, listat, raportet dhe materialet e krijuara ndër vite nga organizata vendore dhe ndërkombëtare të angazhuara në dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, personave të zhdukur dhe pasojave njerëzore të luftës në Kosovë.

Ndër burimet kryesore të kësaj kategorie janë materialet e siguruar nga:

- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNUJ);
- Fondi për të Drejtën Humanitare (Humanitarian Law Center – HLC);
- Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (International Commission on Missing Persons – ICMP);
- Organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare që kanë dokumentuar raste individuale ose pasoja të luftës në Kosovë;
- Lista dhe materiale dokumentuese të përgatitura nga studiues, profesionistë dhe individë të angazhuar në dokumentimin e rasteve.

Këto burime kanë shërbyer për identifikimin e rasteve, krahasimin e të dhënave dhe plotësimin e boshllëqeve në evidencat institucionale. Të dhënat e tyre janë analizuar në mënyrë kritike dhe janë krahasuar me dokumentacionin institucional, burimet plotësuese dhe rezultatet e hulumtimeve të IKKL-së. Kjo qasje ka mundësuar evidentimin e mospërputhjeve, identifikimin e regjistrimeve të mundshme të dyfishta dhe rritjen e saktësisë së të dhënave të përfshira në Listë.

2.2.3 BURIME PLOTËSUESE

Përveç burimeve institucionale dhe materialeve të organizatave vendore e ndërkombëtare, procesi i dokumentimit është mbështetur edhe në burime plotësuese, përfshirë:

- Monografi dhe botime;
- Publikime shkencore dhe profesionale;
- Raporte hulumtuese;
- Dëshmi të familjarëve dhe personave të tjerë me njohuri të drejtpërdrejta për rastin;
- Informacione të siguruar nga zyrtarë komunalë, përfaqësues të fshatrave dhe persona të tjerë relevantë në komunitet;
- Dokumentacion personal dhe familjar;
- Materiale mediale;
- Materiale të organizatave lokale të shoqërisë civile;
- Buletine, regjistra dhe publikime të periudhës së luftës dhe të pasluftës
- Komplekse memoriale, monumente, pllaka përkujtimore dhe burime të tjera të ngjashme.

Burimet plotësuese janë përdorur për saktësimin e identitetit, rrethanave, kohës dhe vendit të ngjarjes, si dhe për orientimin e hulumtimeve të mëtejshme. Pesa e tyre është vlerësuar sipas natyrës së burimit, afërsisë së tij me ngjarjen, mundësisë së verifikimit dhe përputhshmërisë me dokumentacionin tjetër të disponueshëm.

2.3 PARIMET E INTEGRIMIT TË BURIMEVE

Procesi i integritetit të burimeve është mbështetur në katër parime themelore:

1. Plotësueshmëria e burimeve – asnjë burim nuk është trajtuar si i mjaftueshëm në vetvete. Informacionet nga burime të ndryshme janë përdorur në mënyrë plotësuese, me qëllim të plotësimit të të dhënave të paplota dhe krijimit të një evidence sa më kredibile.
2. Krahasueshmëria e të dhënave – para integritetit, të dhënat janë strukturuar dhe standardizuar sipas fushave dhe formateve të njëjta, duke mundësuar krahasimin sistematik të regjistrimeve nga burime të ndryshme.
3. Gjurmueshmëria e burimeve – për secilin rast është ruajtur lidhja me burimin ose burimet përkatëse, në mënyrë që origjina e informacionit dhe historiku i përditësimeve të mund të identifikohen gjatë çdo faze të procesit.
4. Integriteti i informacionit – harmonizimi nuk ka pasur për qëllim ndryshimin e përmbajtjes faktike të burimeve origjinale. Ai është kufizuar në standardizimin, strukturimin dhe ndërlidhjen e të dhënave, ndërsa mospërputhjet ndërmjet burimeve janë ruajtur dhe trajtuar në kuadër të procesit të verifikimit.

2.4 PROCESI I HARMONIZIMIT

Për shkak të numrit, llojshmërisë dhe strukturës së ndryshme të burimeve, harmonizimi ka qenë një nga fazat më komplekse të hartimit të Listës. Në fazën fillestare janë evidentuar, shqyrtuar dhe sistemuar burimet e disponueshme, me qëllim të përcaktimit të përmbajtjes së tyre, strukturës së të dhënave, nivelit të plotësisë dhe mundësisë së përdorimit të tyre në procesin e dokumentimit. Ky vlerësim ka shërbyer si bazë për përcaktimin e mënyrës së integritetit dhe krahasimit të informacioneve.

Më pas është realizuar standardizimi i fushave kryesore të të dhënave, përfshirë:

- emrin;
- mbiemrin;
- emrin e prindit, kur ka qenë i disponueshëm;
- datën e lindjes;
- vendin e lindjes;
- vendbanimin;
- datën e ngjarjes;
- vendin e ngjarjes;
- kategorinë e rastit;
- burimin ose burimet e informacionit.

Pas standardizimit është realizuar krahasimi sistematik i regjistrimeve, me qëllim të identifikimit të rasteve të mundshme të dyfishta, varianteve të emrave, mospërputhjeve në të dhënat personale dhe dallimeve lidhur me datën, vendin ose kategorinë e rastit. Kur të dhënat nga burime të ndryshme nuk kanë qenë të njëjta, rasti është shqyrtuar duke u mbështetur në cilësinë, afërsinë dhe verifikueshmërinë e secilit burim. Në rastet kur mospërputhjet nuk kanë mundur të zgjidhen vetëm përmes dokumentacionit ekzistues, janë zhvilluar hulumtime dhe verifikime shtesë në terren. Ky proces ka mundësuar krijimin e një Liste të integruar dhe të standardizuar, në të cilën çdo rast lidhet me burimet përkatëse dhe me historikun e verifikimit të tij.

KAPITULLI III

METODOLOGJIA E VERIFIKIMIT

3.1 QASJA METODOLOGJIKE

Procesi i hartimit të Listës së personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë është zhvilluar në përputhje me metodologjinë e IKKL-së, të operacionalizuar përmes Udhëzuesit Metodik dhe Operacional për Hartimin dhe Verifikimin e Listës. Metodologjia mbështetet në parimet e dokumentimit profesional, standardizimit të të dhënave, transparencës metodologjike dhe kontrollit të cilësisë në të gjitha fazat e procesit. Qasja e zbatuar nuk ka konsistuar në bashkimin mekanik të listave ekzistuese, por në identifikimin, krahasimin, verifikimin dhe validimin individual të secilit rast. Çdo regjistrim është trajtuar si njësi e veçantë dokumentimi, për të cilën janë shqyrtuar informacionet relevante nga burimet institucionale, arkivore, dokumentare dhe plotësuese, me qëllim të përcaktimit të të dhënave më të besueshme dhe më të verifikueshme. Metodologjia është zbatuar sipas kriterëve të njëjta për të gjitha rastet, pa dallim të përkatësisë etnike, gjinisë, statusit civil ose ushtarak, bindjes politike apo ndonjë përkatësie tjetër. Procesi është udhëhequr nga parimet e objektivitetit, paanshmërisë, dokumentimit të bazuar në burime, respektimit të dinjitetit të personave të dokumentuar dhe ruajtjes së integritetit të të dhënave.

3.2 VLERËSIMI I BESUESHMËRISË SË BURIMEVE

Verifikimi i të dhënave është mbështetur në krahasimin sistematik të burimeve institucionale, regjistrave administrativë, dokumentacionit arkivor dhe gjyqësor, materialeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, publikimeve shkencore e historike, evidencave lokale dhe dokumentacionit të siguruar gjatë hulumtimeve në terren. Besueshmëria e secilit burim është vlerësuar duke marrë parasysh origjinën, autenticitetin, afërsinë me ngjarjen, nivelin e dokumentimit, mundësinë e verifikimit dhe përputhshmërinë me burimet e tjera. Asnjë burim nuk është trajtuar si përfundimtar vetëm për shkak të karakterit të tij institucional ose për shkak se një informacion paraqetj në disa evidenca. Në rastet kur të dhënat nuk përputheshin ndërmjet dy ose më shumë burimeve, nuk është zbatuar parimi i shumicës numerike të burimeve. Secili informacion është vlerësuar në mënyrë individuale, ndërsa vendimi metodologjik është mbështetur në dokumentacion të identifikueshëm dhe të gjurmueshëm. Kur mospërputhjet nuk kanë mundur të zgjidhen përmes analizës së dokumentacionit ekzistues, janë zhvilluar hulumtime në terren, janë konsultuar burime plotësuese ose rasti është mbajtur në shqyrtim deri në sigurimin e informacioneve të mjaftueshme.

3.3 PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË HARMONIZUARA NË PROCESIN E VERIFIKIMIT

Të dhënat e harmonizuara sipas procesit të përshkruar në Kapitullin II kanë shërbyer si bazë për verifikimin individual të rasteve. Standardizimi paraparak i formateve, emërtimeve dhe fushave të të dhënave ka mundësuar krahasimin e regjistrimeve që vinin nga burime të ndryshme dhe identifikimin e mospërputhjeve që kërkonin shqyrtim të mëtejshëm. Gjatë verifikimit, të dhënat e harmonizuara nuk janë trajtuar automatikisht si të konfirmuara.

Për secilin rast janë shqyrtuar dokumentacioni burimor, variantet e evidentuara dhe informacionet plotësuese, me qëllim të përcaktimit të të dhënave më të besueshme. Kur janë konstatuar dallime ndërmjet burimeve, ato janë analizuar dhe zgjidhur sipas kriteve të besueshmërisë të përcaktuara nga IKKL-ja. Çdo korrigjim ose përditësim i bërë gjatë procesit të verifikimit është dokumentuar, ndërsa të dhënat burimore dhe variantet e mëparshme janë ruajtur në historikun e rastit. Kjo ka mundësuar që vendimet metodologjike të jenë të gjurmueshme dhe të rishikueshme.

3.4 VERIFIKIMI, RIVERIFIKIMI DHE VALIDIMI

Procesi i verifikimit është zhvilluar në tri faza të ndërlidhura: verifikimi, riverifikimi dhe validimi. Në fazën e verifikimit janë krahasuar të dhënat e secilit rast me burimet përkatëse, me qëllim të konfirmimit të identitetit, kategorisë së rastit, kohës dhe vendit të ngjarjes, si dhe lidhjes së dokumentuar me luftën në Kosovë. Në këtë fazë janë evidentuar mospërputhjet, janë plotësuar informacionet e munguara dhe janë identifikuar çështjet që kërkonin shqyrtim shtesë. Në fazën e riverifikimit, të dhënat dhe arsyetimi metodologjik janë shqyrtuar nga një zyrtar tjetër i IKKL-së. Ky nivel kontrolli ka synuar identifikimin e gabimeve të mundshme, vlerësimin e qëndrueshmërisë së vendimeve dhe sigurimin e zbatimit të njëtrajtshëm të kriteve metodologjike. Validimi ka përbërë fazën përfundimtare të kontrollit, në të cilën është vlerësuar nëse rasti i plotësonte kriteret metodologjike për përfshirje në Listë. Në përputhje me parimin e ndarjes së detyrave (Separation of Duties), regjistrimi, verifikimi dhe validimi nuk janë kryer nga i njëjti zyrtar. Vetëm rastet që kanë kaluar të gjitha fazat e kontrollit dhe kanë përbushur kriteret metodologjike të IKKL-së janë përfshirë në Listë.

3.5 IDENTIFIKIMI DHE TRAJTIMI I REGJISTRIMEVE TË DYFISHTA

Ndër fazat më komplekse të procesit ka qenë identifikimi dhe trajtimi i regjistrimeve që mund t'i referoheshin të njëjtit person. Për këtë qëllim janë krahasuar kombinime të ndryshme të elementeve identifikuese, përfshirë emrin dhe mbiemrin, emrin e prindit, datën dhe vendin e lindjes, vendbanimin, datën e vrasjes, zhdukjes ose të vdekjes, vendin e ngjarjes, kategorinë e rastit dhe burimet përkatëse. Ngjashmëria e një ose disa elementeve identifikuese nuk është konsideruar automatikisht si provë e duplikimit. Vendimi është marrë vetëm pas shqyrtimit të tërësisë së dokumentacionit dhe të të gjitha të dhënave relevante. Kur është konstatuar se dy ose më shumë regjistrime i referoheshin të njëjtit person, të dhënat janë integruar në një regjistrim të vetëm, ndërsa variantet e identifikuara dhe burimet përkatëse janë ruajtur si pjesë e historikut të rastit. Kur nuk ka qenë e mundur të arrihej në përfundim të mbështetur mjaftueshëm, rasti është mbajtur në shqyrtim deri në sigurimin e dokumentacionit ose informacioneve shtesë.

3.6 KONTROLLI I CILËSISË DHE GJURMUESHMËRIA

Kontrolli i cilësisë është zbatuar gjatë gjithë procesit të hartimit të Listës. Për secilin rast është ruajtur lidhja me burimet përkatëse, janë dokumentuar ndryshimet e kryera dhe është evidentuar arsyetimi metodologjik që ka mbështetur çdo korrigjim, plotësim ose vendim. Metodologjia nuk ka lejuar fshirjen e informacionit historik. Variantet e mëparshme të të dhënave janë ruajtur për qëllime transparence, auditimi dhe verifikimi të mëvonshëm, duke garantuar gjurmueshmërinë e plotë të procesit. Ky mekanizëm mundëson rikonstruktimin dhe verifikimin e çdo ndryshimi të bërë në Listë, duke siguruar integritetin dhe besueshmërinë e evidencës institucionale.

3.7 KUFIZIMET METODOLOGJIKE DHE ZHVILLIMET E ARDHSHME

Lista pasqyron gjendjen e dokumentacionit dhe rezultatet e procesit të verifikimit në kohën e hartimit të këtij raporti. Megjithëse është zbatuar metodologji e unifikuar, disponueshmëria, cilësia dhe plotësia e burimeve nuk kanë qenë të njëjta për të gjitha rastet. Për një numër rastesh vazhdon sigurimi i dokumentacionit plotësues, verifikimi i burimeve shtesë dhe shqyrtimi i mospërputhjeve të mbetura. Përfshirja e një personi në Listë nënkupton se, në kohën e validimit, rasti i plotësonte kriteret metodologjike të IKKL-së dhe mbështetej në dokumentacion të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm. Mungesa e një personi në Listë nuk duhet të interpretohet si provë se ai person nuk është viktimë e luftës. Ajo mund të jetë rezultat i mungesës së dokumentacionit të mjaftueshëm, pamundësisë për zgjidhjen e mospërputhjeve, mosplotësimit të kriteve metodologjike ose faktit se rasti ndodhet ende në proces shqyrtimi. Informacionet e reja mund të çojnë në plotësimin ose korrigjimin e të dhënave, rikategorizimin e rasteve ose rishikimin e vendimeve të mëparshme. Çdo ndryshim do t'i nënshtrohet të njëjtit proces verifikimi, riveifikimi dhe validimi të parashikuar nga metodologjia e IKKL-së.

Në fazat e ardhshme të zhvillimit të databazës institucionale, metodologjia do të plotësohet me kriterë më të detajuara për analiza dhe klasifikime shtesë. Kjo përfshin edhe trajtimin metodologjik të rasteve të personave që kanë humbur jetën pas përfundimit të luftimeve si pasojë e minave tokësore, mjeteve të pashpërthyer dhe mjeteve të tjera shpërthyes të mbetura nga lufta. IKKL-ja nuk pretendon se Lista paraqet evidencë përfundimtare për çdo element faktik të rasteve të dokumentuara dhe përfaqëson evidencën më të verifikuar që ka qenë e mundur të ndërtohet mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm dhe metodologjisë së zbatuar deri në kohën e publikimit.

KAPITULLI IV


PASQYRA E PËRGJITHSHME E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË

4.1 HYRJE

Pasojat njerëzore të luftës përbëjnë njërin nga dimensionet më të rëndësishme të historisë së afërt në Kosovë. Analiza e personave të vrarë, personave të zhdukur me dhunë dhe personave të vdekur si pasojë e luftës mundëson kuptim më të plotë të përmasave të humbjeve njerëzore dhe krijon bazë të besueshme për studimin e pasojave të luftës. Ky kapitull paraqet pasqyrën e përgjithshme statistikore të rasteve të dokumentuara në Listën e IKKL-së.

4.2 NUMRI I PËRGJITHSHËM I PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË

Sipas të dhënave të verifikuara, Lista përfshin gjithsej 13,227 persona të vrarë, persona të zhdukur me dhunë dhe persona të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë. Prej tyre, 12,230 (92.5%) lidhen me periudhën e luftës (1 janar 1998 – 20 qershor 1999), ndërsa 997 (7.5%) me periudhën e pasluftës (21 qershor 1999 – 31 dhjetor 2000), në rastet kur është dokumentuar lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet vdekjes/zhdukjes dhe luftës në Kosovë. Shifrat paraqesin rezultatin e procesit të harmonizimit dhe verifikimit të kryer sipas metodologjisë së IKKL-së.



13, 227
persona

Figura 1. Numri i përgjithshëm i viktimave të luftës në Kosovë (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

4.3 SHPËRNDARJA SIPAS KATEGORIVE

Për qëllime të dokumentimit, personat e përfshirë në listë klasifikohen në tri kategori: persona të vrarë, persona të zhdukur me dhunë dhe persona të vdekur si pasojë e luftës. Kjo ndarje është bërë në përputhje me metodologjinë e IKKL-së dhe mundëson paraqitjen dhe analizimin e rasteve sipas natyrës së tyre. Figura 2 paraqet shpërndarjen e personave të përfshirë në Listë sipas këtyre kategorive. Nga gjithsej 13,227 raste të dokumentuara, 11,408 (86.2%) janë persona të vrarë, 1,578 (11.9%) persona të zhdukur me dhunë dhe 241 (1.8%) persona të vdekur si pasojë e luftës. Këto të dhëna tregojnë se pjesën dërrmuese të rasteve të dokumentuara e përbëjnë personat e vrarë, ndërsa personat e zhdukur me dhunë përfaqësojnë kategorinë e dytë për nga numri i rasteve.




Figura 2. Viktimat sipas kategorive (periudhat: 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

4.4 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS PÛRKATËSISË ETNIKE

Shpërndarja e personave të përfshirë në listë sipas përkatësisë etnike paraqet tregues të rëndësishëm për analizimin e pasojave njerëzore të luftës. Megjithatë, përkatësia etnike paraqet vetëm një nga karakteristikat e rasteve të dokumentuara dhe, e vetme, nuk është e mjaftueshme për të interpretuar strukturën e përgjithshme të humbjeve njerëzore. Për analizë të plotë duhet të merren në konsideratë edhe statusi i personit (civil ose pjesëtar i forcave të armatosura), rrethanat e ngjarjes dhe tregues të tjerë metodologjikë.

Përkatësia etnike	Të vrarë	Të vdekur si pasojë e luftës	Të zhdukur me dhunë	Gjatë luftës (01.01.1998 - 20.06.1999)	Pas luftës (21.06.1999 - 31.12.2000)	Gjithsej
Shqiptarë	9,575	209	1,053	10,518	319	10,837
Serbë	1,492	26	399	1,417	500	1,917
Romë	105	0	33	87	51	138
Boshnjakë	71	4	15	43	47	90
Malazezë	41	0	26	47	20	67
Ashkalinj	47	1	18	47	19	66
Egjiptianë	21	0	15	17	19	36
Tjetër / e panjohur	17	0	11	23	5	28
Goranë	9	0	1	4	6	10
Turq	4	0	4	7	1	8
Hungarezë	7	0	0	7	0	7
Maqedonas	4	0	2	2	4	6
Bullgarë	5	0	0	3	2	5
Jugosllavë	4	0	0	3	1	4
Kroatë	3	1	0	3	1	4
Slovenë	3	0	1	2	2	4
Gjithsej	11,408	241	1,578	12,230	997	13,227

Tabela 1. Viktimat sipas përkatësisë etnike (periudhat: 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

Tabela 1 paraqet shpërndarjen e 13,227 personave të përfshirë në Listë sipas përkatësisë etnike. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të dokumentuara, 10,837 (81.9%) janë shqiptarë, 1,917 (14.5%) serbë, ndërsa pjesa tjetër u përket komuniteteve të tjera ose rasteve me përkatësi etnike të panjohur. Në këtë fazë, IKKL-ja ende nuk e ka përfunduar verifikimin dhe standardizimin e klasifikimit sipas statusit të personave (civilë ose pjesëtarë të forcave të armatosura), prandaj analiza sipas këtij kriteri do të publikohet në fazat e ardhshme të procesit të dokumentimit.

Megjithatë, të dhënat e publikuara nga organizata që kanë dokumentuar edhe statusin e personave, si Fondi për të Drejtën Humanitare (HLC) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDDLNJ), tregojnë se analiza e humbjeve njerëzore vetëm sipas përkatësisë etnike nuk pasqyron plotësisht strukturën e tyre. Sipas të dhënave të HLC-së, mbi 80% e personave shqiptarë të evidentuar si të vrarë janë klasifikuar si viktimat civile, ndërsa rreth 52.4% e personave serbë evidentohen në databazën e HLC-së si pjesëtarë të forcave të armatosura ose të policisë. Këto të dhëna nuk përbëjnë klasifikimin zyrtar të IKKL-së, por ilustron se interpretimi i humbjeve njerëzore kërkon domosdoshmërisht sqyrtimin e statusit të personit dhe rrethanave konkrete të vdekjes, e jo vetëm të përkatësisë etnike.

Lista e IKKL-së nuk përfshin persona që kanë humbur jetën jashtë territorit të Kosovës ose raste që nuk kanë lidhje faktike dhe të dokumentuar me luftën në Kosovë, edhe nëse ato figurojnë në evidenca të institucioneve ose organizatave të tjera. Ky standard metodologjik zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjitha komunitetet dhe siguron që Lista të përfshijë vetëm rastet që bien brenda mandatit ligjor dhe territorial të Institutit. Në fazat e ardhshme të procesit të dokumentimit dhe verifikimit, IKKL-ja do të publikojë analizën e vet të klasifikimit sipas statusit të personave, vendit të ngjarjes dhe rrethanave të vdekjes, duke mundësuar paraqitje edhe më të plotë dhe metodologjikut më të qëndrueshme të strukturës së humbjeve njerëzore gjatë luftës në Kosovë.

KAPITULLI V

ANALIZA DEMOGRAFIKE E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË

5.1 HYRJE

Analiza demografike e personave të përfshirë në Listë plotëson pasqyrën statistikore të humbjeve njerëzore duke shqyrtuar shpërndarjen e tyre sipas gjinisë dhe grupmoshave. Këta tregues mundësojnë identifikimin e grupeve më të prekura të popullsisë dhe ofrojnë kuptim më të plotë të pasojave demografike dhe shoqërore të luftës në Kosovë.

5.2 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS GJINISË

Analiza e të dhënave sipas gjinisë mundëson identifikimin e grupeve më të ekspozuara ndaj pasojave të drejtpërdrejta të luftës dhe kontribuon në kuptimin e karakteristikave të rasteve të dokumentuara.




Figura 3. Viktimat sipas gjinisë (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

Figura 3 paraqet shpërndarjen e personave të përfshirë në listë sipas gjinisë. Nga gjithsej 13,227 persona, 11,415 (86.3%) janë meshkuj dhe 1,811 (13.7%) janë femra, ndërsa për një rast (0.01%) gjinia nuk ka mundur të përcaktohet në këtë fazë të procesit të dokumentimit. Kjo shpërndarje tregon se humbjet njerëzore gjatë luftës kanë prekur në mënyrë disproporcionale popullsinë mashkullore, e cila përbën pjesën dërrmuese të rasteve të dokumentuara. Megjithatë, dokumentimi i 1,811 grave dëshmon se pasojat e luftës nuk janë kufizuar vetëm te meshkujt, por kanë prekur edhe gjininë femërore. Analiza sipas gjinisë duhet të interpretohet në lidhje me tregues të tjerë demografikë dhe metodologjikë, veçanërisht me moshën, statusin e personit dhe rrethanat e ngjarjes, për të mundësuar kuptim më të thelluar të strukturës së humbjeve njerëzore gjatë luftës në Kosovë.

5.3 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS GRUPMOSHAVE

Kjo analizë paraqet strukturën demografike të personave të përfshirë në listë dhe mundëson identifikimin e grupmoshave që janë prekur më shumë nga humbjet njerëzore gjatë luftës. Tabela 2 tregon se humbjet njerëzore janë përqendruar kryesisht në popullsinë e moshës aktive. Grupmosha 31–50 vjeç përfaqëson kategorinë më të madhe, me 4,080 persona (30.8%), e ndjekur nga grupmosha 18–30 vjeç, me 3,531 persona (26.7%). Së bashku, këto dy grupmosha përbëjnë më shumë se gjysmën e të gjithë personave të përfshirë në Listë (57.5%), duke treguar se lufta ka prekur në mënyrë disproporcionale popullsinë në moshë pune. Njëkohësisht, të dhënat tregojnë se pasojat e luftës nuk janë kufizuar vetëm në popullsinë e rritur. Në Listë dokumentohen 1,241 fëmijë (9.4%) të moshës deri në 17 vjeç dhe 1,949 persona (14.7%) mbi moshën 65 vjeç. Këto dy kategori përbëjnë grupet më të cenueshme të popullsisë dhe prania e tyre në Listë dëshmon se pasojat e luftës kanë prekur edhe fëmijët dhe të moshuarit. Shpërndarja sipas grupmoshave duhet të interpretohet në lidhje me tregues të tjerë demografikë dhe metodologjikë, si gjinia, statusi i personit dhe rrethanat e ngjarjes, për të mundësuar analiza më të thelluara të strukturës së humbjeve njerëzore gjatë luftës në Kosovë.

Grupmosha	Të vrarë	Të vdekur si pasojë e luftës	Të zhdukur me dhunë	Gjatë luftës	Pas luftës	Gjithsej	%
				01.01.1998 – 20.06.1999	21.06.1999 – 31.12.2000		
0–17 vjeç	1,047	94	100	1,176	65	1,241	9.4
18–30 vjeç	3,156	40	335	3,325	206	3,531	26.7
31–50 vjeç	3,541	34	505	3,772	308	4,080	30.8
51–65 vjeç	2,036	28	347	2,184	227	2,411	18.2
Mbi 65 vjeç	1,615	45	289	1,766	183	1,949	14.7
Mosha e panjohur	13	0	2	7	8	15	0.1
Gjithsej	11,408	241	1,578	12,230	997	13,227	100

Tabela 2. Viktimat sipas grup moshave (1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

Kur analizohen të dhënat sipas grupmoshave dhe përkatësisë etnike, vërehen dallime të theksuara në numrin e fëmijëve të përfshirë në Listë. Në grupmoshën 0–17 vjeç janë evidentuar gjithsej 1,241 raste. Prej tyre, 1,156 (93.2%) janë fëmijë me përkatësi etnike shqiptare, ndërsa 42 (3.4%) janë me përkatësi etnike serbe. Numri i rasteve për komunitetet e tjera është më i ulët: 19 romë, 14 ashkalinj, 5 egjiptianë, ndërsa me nga 1 rast është evidentuar për komunitetet kroat, malazez dhe turk. Dy raste janë klasifikuar me përkatësi tjetër ose të panjohur. Këto të dhëna tregojnë se fëmijët me përkatësi etnike shqiptare përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve të dokumentuara në këtë grupmoshë, ndërsa fëmijët e komuniteteve të tjera përfaqësohen me numër dukshëm më të vogël në Listë.

Ky dallim pasqyron edhe ndikimin disproporcional që lufta pati mbi fëmijët e komunitetit shqiptar. Në terma absolutë, numri i fëmijëve shqiptarë të përfshirë në Listë është rreth 27 herë më i lartë se numri i fëmijëve serbë (1,156 kundrejt 42), ndërsa krahasuar me secilin prej komuniteteve të tjera dallimi është edhe më i madh.

KAPITULLI VI

ANALIZA GJEOGRAFIKE E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË

6.1 HYRJE

Analiza gjeografike paraqet shpërndarjen territoriale të personave të përfshirë në Listë dhe mundëson identifikimin e rajoneve dhe komunave më të prekura nga humbjet njerëzore gjatë luftës në Kosovë. Shpërndarja territoriale e rasteve pasqyron intensitetin e ngjarjeve të dokumentuara në zona të ndryshme të vendit dhe ofron pasqyrë mbi dimensionin hapësinor të luftës.

6.2 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS RAJONEVE

Analiza sipas rajoneve paraqet nivelin e parë të shpërndarjes territoriale të personave të përfshirë në Listë. Klasifikimi është bërë sipas metodologjisë së IKKL-së, duke u bazuar në komunën e vendlindjes, vendbanimit ose vendit të ngjarjes, varësisht nga të dhënat e dokumentuara për secilin rast. Tabela 3 tregon se humbjet njerëzore janë shpërndarë në të gjitha rajonet e Kosovës, megjithëse me intensitet të ndryshëm. Numrin më të madh të personave të përfshirë në Listë e ka Rajoni i Gjakovës, me 2,578 raste (19.5%), i ndjekur nga Rajoni i Mitrovicës, me 2,543 raste (19.2%), Rajoni i Prishtinës, me 2,454 raste (18.6%), dhe Rajoni i Pejës, me 2,127 raste (16.1%). Këto katër rajone përbëjnë së bashku mbi 73% të të gjitha rasteve të dokumentuara në Listë. Rajonet e Prizrenit (1,335 raste; 10.1%), Ferizajt (668 raste; 5.0%) dhe Gjilanit (421 raste; 3.2%) kanë numër më të ulët të rasteve të dokumentuara krahasuar me rajonet e tjera. Këto dallime pasqyrojnë shpërndarjen territoriale të rasteve të dokumentuara dhe lidhen me intensitetin e zhvillimeve të luftës në zona të ndryshme të Kosovës. Megjithatë, ato nuk duhet të interpretohen të ndara nga faktorë të tjerë, si dinamika e operacioneve ushtarake, lëvizjet e popullsisë dhe rrethanat konkrete të secilit rast.

Rajoni	Të vrarë	Të vdekur si pasojë e luftës	Të zhdukur me dhunë	Gjatë luftës	Pas luftës	Gjithsej
				01.01.1998 – 20.06.1999	21.06.1999 – 31.12.2000	
Rajoni i Prishtinës	2,225	44	185	2,283	171	2,454
Rajoni i Mitrovicës	2,245	88	210	2,438	105	2,543
Rajoni i Pejës	1,707	20	400	2,001	126	2,127
Rajoni i Gjakovës	2,230	27	321	2,468	110	2,578
Rajoni i Prizren	1,063	15	257	1,228	107	1,335
Rajoni i Ferizajt	582	18	68	600	68	668
Rajoni i Gjilanit	385	4	32	284	137	421
E panjohur	971	25	105	928	173	1,101
Gjithsej	11,408	241	1,578	12,230	997	13,227

Tabela 3. Viktimat sipas rajoneve (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

6.3 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS KOMUNAVE

Analiza sipas rajoneve paraqet nivelin e parë të shpërndarjes territoriale të personave të përfshirë në L. Analiza sipas komunave ofron nivelin më të detajuar të shpërndarjes territoriale të personave të përfshirë në Listë dhe mundëson identifikimin e zonave, që kanë pësuar humbjet më të mëdha njerëzore gjatë luftës. Klasifikimi është realizuar kryesisht sipas komunës së vendlindjes, vendbanimit ose vendit të ngjarjes, në varësi të të dhënave të dokumentuara për secilin rast. Kur komuna nuk ka mundur të identifikohet nga dokumentacioni i disponueshëm, rasti është klasifikuar në kategorinë "E panjohur", ndërsa për personat e lindur jashtë territorit të Kosovës janë përdorur kategoritë përkatëse shtetërore.

6.4 KOMUNAT MË TË PREKURA TË KOSOVËS

Ky seksion paraqet komunat me numrin më të madh të personave të përfshirë në Listë dhe ofron një pasqyrë të përqendrimit territorial të humbjeve njerëzore gjatë luftës. Figura 4 paraqet dhjetë komunat me numrin më të madh të personave të përfshirë në Listë. Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e humbjeve njerëzore është përqendruar në një numër relativisht të vogël komunash, të cilat së bashku përfaqësojnë mbi 60% të të gjitha rasteve të dokumentuara. Ky përqendrim pasqyron intensitetin e zhvillimeve të luftës në këto zona, në të cilat janë dokumentuar operacione të gjera ushtarake, masakra, zhvendosje të detyruara të popullsisë dhe ngjarje të tjera me pasoja të rënda njerëzore. Shpërndarja territoriale e rasteve tregon se ndikimi i luftës nuk ka qenë i njëtrajtshëm në të gjithë territorin e Kosovës, por është karakterizuar nga dallime të theksuara ndërmjet komunave. Megjithatë, numri i personave të dokumentuar për secilën komunë nuk duhet të interpretohet si tregues i vetëm i intensitetit të luftës, pasi ai ndikohet edhe nga faktorë të tjerë, si dinamika e operacioneve ushtarake, lëvizjet e popullsisë, vendi i ngjarjes dhe shkalla e dokumentimit të rasteve. Analiza sipas komunave ofron bazë të rëndësishme për studime më të detajuara mbi dimensionin lokal të humbjeve njerëzore dhe do të plotësohet në publikimet e ardhshme të IKKL-së me analiza sipas statusit të personave, rrethanave të ngjarjes dhe treguesve të tjerë metodologjikë.




Figura 4. Komunat me numrin më të lartë të viktimave (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 – 31 dhjetor 2000)

KAPITULLI VII

ANALIZA KOHORE E RASTEVE TË DOKUMENTUARA

7.1 HYRJE

Analiza kohore e personave të përfshirë në Listë paraqet shpërndarjen e rasteve sipas periudhave, viteve dhe muajve të ngjarjes. Kjo analizë mundëson identifikimin e fazave me intensitetin më të lartë të humbjeve njerëzore dhe ofron pasqyrë mbi dinamikën kohore të luftës në Kosovë. Shqyrtimi i këtyre treguesve ndihmon në kuptimin e lidhjes ndërmjet zhvillimeve kryesore të luftës dhe shpërndarjes së rasteve të dokumentuara.

7.2 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË GJATË LUFTËS DHE PAS LUFTËS

Për qëllime analitike, raporti dallon ndërmjet periudhës së luftës (1 janar 1998 – 20 qershor 1999) dhe periudhës së pasluftës (21 qershor 1999 – 31 dhjetor 2000). Kjo ndarje mundëson analizimin e shpërndarjes kohore të personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të personave të vdekur si pasojë e luftës, si dhe evidentimin e ndryshimeve në dinamikën e humbjeve njerëzore ndërmjet dy periudhave (shih figurën 1).

7.3 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS VITEVE

Tabela 4 paraqet shpërndarjen e personave të përfshirë në Listë sipas vitit të ngjarjes dhe ilustron se humbjet njerëzore janë përqendruar pothuajse tërësisht gjatë viteve 1998 dhe 1999. Numrin më të madh të rasteve e regjistron viti 1999, me 11,005 persona (83.2%), ndërsa gjatë vitit 1998 janë dokumentuar 2,098 raste (15.9%). Në vitin 2000 janë evidentuar 124 raste (0.9%), të cilat lidhen me ngjarje të ndodhura gjatë periudhës së pasluftës.

Viti	Të vrarë	Të vdekur si pasojë e luftës	Të zhdukur me dhunë	Gjatë luftës	Pas luftës	Gjithsej	%
				01.01.1998 – 20.06.1999	21.06.1999 – 31.12.2000		
1998	1,792	69	237	2,098	0	2,098	15.9
1999	9,506	170	1,329	10,132	873	11,005	83.2
2000	110	2	12	0	124	124	0.9
Gjithsej	11,408	241	1,578	12,230	997	13,227	100

Tabela 4: Viktimat sipas viteve (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

Dominimi i vitit 1999 pasqyron fazën më intensive të luftës në Kosovë, gjatë së cilës janë dokumentuar shumica e vrasjeve, zhdukjeve me dhunë dhe rasteve të tjera të përfshira në Listë. Në të njëjtën kohë, të dhënat tregojnë se procesi i dokumentimit nuk përfundon me përfundimin formal të luftës, pasi një numër rastesh është regjistruar edhe gjatë periudhës së pasluftës.

7.4 PERSONAT E PËRFSHIRË NË LISTË SIPAS MUAJVE

Analiza sipas muajve mundëson identifikimin e periudhave me intensitetin më të lartë të humbjeve njerëzore gjatë luftës. Të dhënat e paraqitura në tabelën 5, tregojnë se shpërndarja mujore e rasteve nuk është e njëtrajtshme. Numri më i madh i personave të përfshirë në Listë është dokumentuar gjatë muajve mars, prill dhe maj 1999, të cilët së bashku përfshijnë 9,398 raste, ose rreth 71% të të gjitha rasteve të dokumentuara në Listë. Muaji prill 1999 paraqet periudhën me numrin më të madh të rasteve (3,987), i ndjekur nga marsi (2,585) dhe maji (2,432). Ky përqendrim dëshmon se faza kulmore e humbjeve njerëzore ka ndodhur gjatë pranverës së vitit 1999, periudhë që përkon me intensifikimin e operacioneve ushtarake dhe me disa nga ngjarjet më të rënda të dokumentuara gjatë luftës. Në krahasim me këtë periudhë, muajt e tjerë të viteve 1998, 1999 dhe 2000 paraqesin numër dukshëm më të ulët rastesh, duke reflektuar ndryshimet në intensitetin e luftës gjatë fazave të ndryshme të saj.

Muaji	1998	1999	2000
Janar	30	214	12
Shkurt	36	121	20
Mars	98	2,585	14
Prill	57	3,987	14
Maj	200	2,432	11
Qershor	184	994	15
Korrik	434	301	2
Gusht	332	139	8
Shtator	490	112	10
Tetor	79	48	4
Nëntor	49	31	8
Dhjetor	109	41	6
Gjithsej	2,098	11,005	124
Totali	13,227		

Tabela 5: Viktimat sipas viteve dhe muajve (periudhat; 1 janar 1998 – 20 qershor 1999 dhe 21 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000)

7.5 PERIUDHAT ME NUMRIN MË TË LARTË TË PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË LISTË

Analiza kohore tregon se humbjet njerëzore nuk janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme gjatë luftës, por janë përqendruar në periudha të caktuara. Kulmi i rasteve të dokumentuara përkon me fazën më intensive të luftës në Kosovë, gjatë pranverës së vitit 1999, kur në shumë zona të vendit u zhvilluan operacione të gjera ushtarake dhe u dokumentuan disa nga ngjarjet me pasoja më të rënda njerëzore. Brenda kësaj periudhe, 26 prilli 1999 rezulton dita me numrin më të madh të personave të evidentuar në Listën preliminare të IKKL-së, duke reflektuar përqendrimin e një numri të madh ngjarjesh në një interval shumë të shkurtër kohor. Këto rezultate tregojnë se dinamika e humbjeve njerëzore lidhet ngushtë me zhvillimin e luftës dhe intensitetin e ngjarjeve të dokumentuara në periudha të caktuara të luftës.

KAPITULLI VIII

CILËSIA E TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMI I LISTËS PRELIMINARE

8.1 HYRJE

Besueshmëria e çdo Liste të personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të personave të vdekur si pasojë e luftës varet nga numri i rasteve të dokumentuara, por edhe nga cilësia e të dhënave, metodologjia e përdorur dhe procedurat e verifikimit të informacionit. Për këtë arsye, IKKL-ja ka zhvilluar sistem të standardizuar për mbledhjen, administrimin, harmonizimin dhe verifikimin e të dhënave, me qëllim sigurimin e saktësisë, gjurmueshmërisë dhe transparencës së çdo regjistrimi. Lista preliminare është ndërtuar mbi një platformë moderne të menaxhimit të të dhënave, e cila mundëson integrimin e burimeve të shumta, ruajtjen e historikut të ndryshimeve dhe përditësimin e vazhdueshëm të evidencës. Kjo qasje siguron që çdo informacion të jetë i dokumentuar, i verifikueshëm dhe i mbështetur në burime të identifikueshme.

8.2 STRUKTURA E TË DHËNAVE

Lista e personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës, është ndërtuar mbi bazën e një strukture të dhënash që përbën themelin e databazës së IKKL-së. Kjo strukturë organizon informacionin mbi viktimat, burimet dokumentare, kategoritë e rasteve të dokumentuara, vendin dhe kohën e ngjarjes, procesin e verifikimit, si dhe elemente të tjera relevante për dokumentimin e secilit rast. Një organizim i tillë mundëson harmonizimin dhe krahasimin e burimeve të ndryshme, duke ruajtur njëkohësisht gjurmueshmërinë e informacionit dhe burimin e secilit regjistrim. Në këtë fazë, lista është konceptuar në mënyrë që të dallojë qartë të dhënat burimore nga të dhënat e harmonizuara dhe të verifikuara. Kjo qasje mundëson ruajtjen e informacionit original, dokumentimin e çdo ndryshimi të bërë gjatë procesit të verifikimit dhe krijon bazën për përditësimin e vazhdueshëm të evidencës. Në këtë mënyrë sigurohen konsistenca, transparenca dhe besueshmëria e të dhënave, në përputhje me metodologjinë e IKKL-së.

8.3 PARIMET E ADMINISTRIMIT TË DATABAZËS

Procesi është zhvilluar mbi katër parime themelore:

1. Gjurmueshmëria e informacionit ka shërbyer si njëri nga parimet themelore të procesit gjatë hartimit të listës të viktimave të luftës në Kosovë. Çdo regjistrim i përfshirë në listë është lidhur me burimin ose burimet përkatëse dokumentare nga të cilat është siguruar informacioni.
2. Verifikueshmëria – lista është ndërtuar mbi parimin që çdo informacion i përfshirë duhet të mbështetet në dokumentacion të identifikueshëm dhe të verifikueshëm. Për këtë arsye, të dhënat janë krahasuar dhe vlerësuar në raport me burime të ndryshme dokumentare, me qëllim që informacioni i regjistruar të jetë sa më i saktë dhe i mbështetur në evidencë. Në rastet kur janë identifikuar mospërputhje ndërmjet burimeve, janë zbatuar procedura shtesë të verifikimit dhe rivlerësimit.
3. Konsistenca - për shkak të përdorimit të burimeve të shumta dhe të ndryshme, një aspekt i rëndësishëm gjatë hartimit të listës ka shërbyer edhe siguri i konsistencës së të dhënave.

Të gjitha informacionet janë harmonizuar dhe standardizuar në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga IKKL, duke përdorur formate të njëjta për emrat, datat, vendbanimet, kategoritë e viktimave dhe elementet e tjera identifikuese.

4. Transparenca - procedurat e përdorura për harmonizimin e burimeve, trajtimin e mospërputhjeve, eliminimin e duplikateve dhe klasifikimin e rasteve janë dokumentuar në mënyrë sistematike. Kjo siguron që procesi të jetë i kuptueshëm, i riprodhueshëm dhe i verifikueshëm, duke rritur besueshmërinë e listës dhe të rezultateve të paraqitura në këtë raport.
5. Përditësueshmëria dhe pjesëmarrja publike – databaza është konceptuar që në filltet e saj si sistem dinamik, i hapur për plotësimin, përditësimin dhe korrigjimin e vazhdueshëm të të dhënave për secilin rast. Nëpërmjet platformës së IKKL-së, palët e interesuara, e veçanërisht familjarët e personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës, kanë mundësinë të ngarkojnë dokumente, dëshmi dhe informacione shtesë, si dhe të propozojnë korrigjime të të dhënave ekzistuese kur ato rezultojnë të pasakta ose jo të plota. Çdo informacion i ri i nënshtrohet procedurave të verifikimit përpara se të integrohet. Kjo qasje siguron që databaza mund të plotësohet dhe përmirësohet vazhdimisht, gjithnjë duke ofruar dokumentim sa më të plotë, të saktë dhe të mbështetur në evidencë.

8.4 HARMONIZIMI I BURIMEVE

Një nga elementet kryesore që ndikon në cilësinë e listës është integrimi i burimeve të shumta.

Përmes procesit të harmonizimit janë identifikuar:

- duplikatet;
- mospërputhjet;
- mungesat në të dhëna;
- dallimet terminologjike.

Ky proces ka mundësuar rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së evidencës.

8.5 KUFIZIMET DHE PËRDITËSIMI I LISTËS PRELIMINARE

Megjithëse lista e IKKL-së përfaqëson evidencën më të plotë institucionale të zhvilluar deri më sot mbi personat e vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës në Kosovë, IKKL vlerëson se dokumentimi i rasteve të kësaj natyre është proces i vazhdueshëm. Përvoja ndërkombëtare dëshmon se, edhe shumë vite pas përfundimit të luftërave vazhdojnë të identifikohen dokumente, dëshmi, arkiva dhe burime të reja, të cilat mund të ndikojnë në plotësimin, korrigjimin ose përditësimin e të dhënave ekzistuese. Për këtë arsye, kjo listë e IKKL-së duhet të konsiderohet si evidencë dinamike dhe e përditësueshme, e cila do të vazhdojë të zhvillohet në përputhje me informacionet e reja, rezultatet e hulumtimeve shtesë dhe proceset e mëtejshme të verifikimit, duke ruajtur në çdo fazë standardet metodologjike, transparencën, gjurmueshmërinë dhe integritetin e të dhënave. Për të mundësuar administrimin efikas të kësaj evidence dhe për të garantuar përditësimin e saj të vazhdueshëm, IKKL ka zhvilluar platformë të dedikuara elektronike (<https://lista-ikkl.rks-gov.net/>), përmes së cilës administrohen, verifikohen dhe përditësohen të dhënat e personave të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe të vdekur si pasojë e luftës.

9.1 GJETJET STATISTIKORE

Analiza statistikore e Listës preliminare nxjerr në pah disa gjetje kryesore. Së pari, procesi i harmonizimit dhe verifikimit të burimeve ka mundësuar krijimin e evidencës institucionale më të plotë deri më tani për personat e vrarë, të zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës në Kosovë gjatë periudhës 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000. Së dyti, krahasimi sistematik i burimeve ka treguar se përdorimi i metodologjisë së standardizuar ka mundësuar identifikimin e duplikateve, korrigjimin e mospërputhjeve dhe plotësimin e një numri të konsiderueshëm të të dhënave të paplota. Kjo ka rritur besueshmërinë, konsistencën dhe cilësinë e evidencës së krijuar.

9.2 GJETJET DEMOGRAFIKE

Analiza demografike tregon se humbjet njerëzore kanë prekur të gjitha kategoritë e popullsisë, por jo në mënyrë të barabartë. Pjesën më të madhe të personave të përfshirë në Listë e përbëjnë meshkujt, ndërsa sipas grupmoshave dominon popullsia në moshë aktive (18–50 vjeç). Megjithatë, dokumentimi i një numri të konsiderueshëm fëmijësh dhe personash mbi moshën 65 vjeç dëshmon se pasojat e luftës kanë prekur edhe grupet më të cënueshme të popullsisë. Analiza sipas përkatësisë etnike tregon se Lista përfshin persona nga të gjitha komunitetet që kanë pësuar humbje njerëzore gjatë luftës, duke ofruar kështu bazë të rëndësishme për studimin e strukturës demografike të humbjeve njerëzore.

9.3 GJETJET GJEOGRAFIKE

Analiza territoriale tregon se humbjet njerëzore janë regjistruar në të gjitha rajonet e Kosovës, por me intensitet të ndryshëm. Një pjesë e konsiderueshme e rasteve është përqendruar në një numër relativisht të vogël rajonesh dhe komunash, ndërsa dhjetë komunat me numrin më të madh të personave të përfshirë në Listë arrijnë mbi 60% të të gjitha rasteve të dokumentuara. Kjo shpërndarje dëshmon se pasojat njerëzore të luftës nuk kanë qenë të njëtrajtshme në të gjithë territorin e Kosovës, por janë përqendruar në zonat në të cilat janë zhvilluar disa nga ngjarjet më intensive të luftës.

9.4 GJETJET KOHORE

Analiza kohore tregon se humbjet njerëzore janë përqendruar kryesisht gjatë vitit 1999, i cili përfshin mbi katër të pestat e të gjitha rasteve të dokumentuara. Në veçanti, muajt mars, prill dhe maj 1999 përfaqësojnë periudhën me intensitetin më të lartë të humbjeve njerëzore, ndërsa vetëm gjatë kësaj periudhe tremujore janë dokumentuar rreth 71% e të gjitha rasteve të përfshira në Listë. Këto rezultate tregojnë se humbjet njerëzore nuk kanë qenë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme gjatë luftës, por janë përqendruar në fazën kulmore të saj.

9.5 GJETJA KYESORE E RAPORTIT

Procesi i harmonizimit, standardizimit dhe verifikimit të të dhënave, i zhvilluar sipas metodologjisë së IKKL-së, ka mundësuar hartimin e një Liste me 13,227 persona të vrarë, të zhdukur me dhunë dhe persona të vdekur si pasojë e luftës, për periudhën 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000. Lista përfaqëson evidencën më të plotë institucionale të zhvilluar deri më tani për dokumentimin e humbjeve njerëzore të luftës në Kosovë. Megjithatë në përputhje me metodologjinë e IKKL-së dhe praktikën ndërkombëtare të dokumentimit të humbjeve njerëzore, Lista preliminare mbetet evidencë dinamike, e cila do të vazhdojë të plotësohet dhe të përditësohet në bazë të dëshmive dhe informacioneve të reja që do t'i nënshtrohen procedurave të verifikimit.

KAPITULLI X

RËNDËSIA E LISTËS PËR KUJTESËN KOLEKTIVE DHE DREJTËSINË TRANZICIONALE

10.1 KUJTESA KOLEKTIVE

Njëri nga detyrimet themelore të IKKL-së është dokumentimi, ruajtja dhe promovimi i fakteve që lidhen me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe pasojat e tyre njerëzore. Në këtë kuadër, Lista preliminare dhe databaza që po zhvillohet mbi bazën e saj përbëjnë mekanizëm institucional për dokumentimin dhe ruajtjen e kujtesës kolektive. Çdo person i përfshirë në Listë përfaqëson më shumë sesa një regjistrim statistikor. Pas çdo rasti të dokumentuar qëndron një histori individuale, një familje dhe një komunitet i prekur nga lufta. Përmes identifikimit, verifikimit dhe dokumentimit sistematik të secilit rast, IKKL-ja kontribuon në ruajtjen e kujtesës së këtyre personave dhe në ndërtimin e evidencës së bazuar në fakte të dokumentuara dhe burime të verifikueshme. Databaza është konceptuar që, krahas të dhënave identifikuese dhe statistikore, të integrojë gradualisht dokumente arkivore, fotografi, materiale audiovizuale, dëshmi dhe narracione historike që lidhen me secilin rast. Në këtë mënyrë, ajo synon të zhvillohet nga një evidencë statistikore në një arkiv të dokumentuar të humbjeve njerëzore të luftës në Kosovë. Një mekanizëm i tillë padyshim se kontribuon në ruajtjen e kujtesës kolektive, mbështet edukimin mbi pasojat e luftës dhe krijon bazë faktike për t'iu kundërvënë mohimit, shtrembërimit ose relativizimit të krimeve dhe pasojave njerëzore të luftës.

10.2 HULUMTIMI DHE EDUKIMI

Në përputhje me mandatin ligjor të IKKL-së, dokumentimi i humbjeve njerëzore nuk kufizohet vetëm në administrimin e evidencës, por krijon edhe bazë për hulumtim shkencor dhe edukim publik. Të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare janë harmonizuar dhe integruar në një sistem të vetëm referencial. Kjo krijon mundësi të reja për analiza historike, politike, juridike, sociologjike, demografike dhe studime në fushën e drejtësisë tranzicionale. Databaza e IKKL-së pritet të shërbejë si burim referues për studiuesit, universitetet dhe institucionet akademike, si dhe të mbështesë përgatitjen e publikimeve shkencore, ekspozitave me materiale edukative dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik. Në këtë mënyrë, kontribuon në zhvillimin e njohurive të bazuara në evidencë mbi pasojat njerëzore të luftës në Kosovë.

10.3 RËNDËSIA PËR POLITIKAT PUBLIKE DHE INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Lista preliminare krijon bazë të verifikuar të të dhënave, e cila do të mbështesë institucionet e Republikës së Kosovës në hartimin e politikave publike, dokumenteve strategjike dhe analizave që lidhen me trashëgiminë e luftës. Të dhënat e saj mund të përdoren gjatë përgatitjes së raporteve zyrtare, programeve memorializuese, iniciativave arsimore dhe politikave që kanë të bëjnë me kategoritë e prekura nga lufta. Po ashtu, ato forcojnë kapacitetin institucional të Republikës së Kosovës për të prezantuar evidencë të standardizuar dhe të verifikuar në komunikimin me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë. Një nga rezultatet më të rëndësishme të këtij procesi është krijimi i evidencës institucionale të unifikuar mbi humbjet njerëzore të luftës në Kosovë, e cila do të shërbejë si pikë referimi për institucionet publike dhe proceset e ardhshme të dokumentimit.

10.4 DREJTËSIA TRANZICIONALE

Dokumentimi i humbjeve njerëzore është komponent e rëndësishme e proceseve të drejtësisë tranzicionale dhe të ballafaqimit me të kaluarën. Në këtë kuptim, Lista preliminare e IKKL-së forcon bazën faktike mbi pasojat njerëzore të luftës në Kosovë dhe krijon evidencë të standardizuar që mund të përdoret në proceset e hulumtimit, memorializimit dhe analizës. Mandati i IKKL-së nuk përfshin përcaktimin e përgjegjësisë penale ose individuale për krimet e luftës. Megjithatë, dokumentimi sistematik i humbjeve njerëzore kontribuon në të drejtën për të vërtetën dhe mbështet proceset më të gjera të drejtësisë, duke siguruar që pasojat njerëzore të luftës të dokumentohen mbi bazën e fakteve të verifikuara. Përvoja ndërkombëtare tregon se evidencat e standardizuara mbi humbjet njerëzore janë element i rëndësishëm i komisioneve të së vërtetës, proceseve memorializuese, kërkimeve shkencore dhe politikave publike që lidhen me trashëgiminë e luftës. Në këtë drejtim, databaza e IKKL-së krijon bazë të qëndrueshme për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave dhe për zhvillimin e analizave të mëtejshme mbi pasojat e luftës në Kosovë.

KONKLUZIONE

Ky raport paraqet rezultatin e procesit të harmonizimit, verifikimit dhe standardizimit të të dhënave mbi personat e vrarë, të zhdukur me dhunë dhe personat e vdekur si pasojë e luftës në Kosovë për periudhën 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000. Përmes integritetit të burimeve të shumta vendore dhe ndërkombëtare dhe zbatimit të një metodologjie të unifikuar, IKKL-ja ka hartuar Listën preliminare me 13,227 persona, duke krijuar evidencën më të plotë institucionale të zhvilluar deri më sot për dokumentimin e humbjeve njerëzore të luftës në Kosovë. Vlera e këtij procesi nuk qëndron vetëm në numrin e rasteve të dokumentuara. Të dhënat e mbledhura ndër vite nga institucione, organizata dhe burime të ndryshme janë harmonizuar në një sistem të vetëm, të ndërtuar mbi standarde metodologjike të unifikuara, procedura të dokumentuara verifikimi dhe parime të gjurmueshmërisë së informacionit. Kjo krijon bazë të qëndrueshme për dokumentimin, analizimin dhe administrimin afatgjatë të evidencës mbi humbjet njerëzore të luftës.

Gjithashtu, Lista preliminare konsiderohet vetëm fillimi i procesit të dokumentimit të viktimave të luftës në Kosovë. Përvojat ndërkombëtare tregojnë se edhe shumë vite pas përfundimit të luftërave vazhdojnë të identifikohen dokumente, dëshmi dhe burime të reja që mund të plotësojnë, saktësojnë ose korrigjojnë evidencat ekzistuese. Për këtë arsye, Lista preliminare duhet të kuptohet si evidencë dinamike, e cila do të vazhdojë të përditësohet në përputhje me metodologjinë e IKKL-së dhe standardet e verifikimit të zbatuara në këtë proces. Në fazat e ardhshme, IKKL-ja do të vazhdojë zhvillimin e databazës përmes integritetit të dokumentacionit të ri, verifikimeve shtesë dhe publikimit të analizave të specializuara, përfshirë klasifikimet sipas statusit civil ose të uniformuar, profileve demografike, rrethanave të ngjarjes dhe treguesve të tjerë metodologjikë. Njëkohësisht, Instituti synon ta zgjerojë procesin e dokumentimit edhe për periudhat që paraprijnë luftën, në përputhje me mandatin e tij ligjor për dokumentimin e krimeve të kryera para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Dokumentimi i humbjeve njerëzore është proces që kërkon bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, komunitetit akademik, familjarëve të viktimave dhe qytetarëve. Kontributi i tyre mbetet i rëndësishëm për plotësimin dhe verifikimin e mëtejshëm të evidencës. Në këtë frymë, IKKL-ja mbetet e hapur për pranimin e dokumenteve, dëshmime dhe informacioneve të reja, të cilat do t'i nënshtrohen të njëjtave procedura të verifikimit dhe validimit të zbatuara gjatë hartimit të kësaj evidence. Kjo Listë preliminare është baza mbi të cilën do të zhvillohet databaza institucionale e humbjeve njerëzore të luftës në Kosovë. Përveç funksionit të saj dokumentues, ajo krijon edhe bazë të besueshme referuese për institucionet e Republikës së Kosovës, studiuesit, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, duke mbështetur ruajtjen e kujtesës kolektive, zhvillimin e hulumtimeve shkencore, edukimin publik dhe proceset e drejtësisë tranzicionale.

Për të mbështetur këtë proces, IKKL-ja ka zhvilluar platformë digjitale për administrimin dhe përditësimin e databazës. Platforma do të mundësojë pranimin dhe shqyrtimin e dokumenteve, dëshmime dhe informatave shtesë, si dhe propozimin e korrigjimeve nga familjarët, institucionet dhe palët e tjera të interesuara. Çdo informacion i ri do t'i nënshtrohet procedurave të verifikimit përpara se të integrohet në databazë. Publikimi i Listës shënon etapë të rëndësishme në ndërtimin e kësaj evidence institucionale të standardizuar mbi humbjet njerëzore të luftës në Kosovë. IKKL-ja mbetet e përkushtuar për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj evidence, në përputhje me mandatin e saj ligjor, me qëllim që dokumentimi i krimeve dhe pasojave të luftës të mbështetet në fakte të verifikuara, metodologji dhe standarde profesionale.

ISBN 978-9951-9232-1-7



9 789951 923217